



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2019:114271

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05671180

**PKR.nr.404/2005**

**- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i trupit gjykues Fatos Sejdiqaj, me bashkëpunëtoreshen profesionale Donjeta Tahiri, në çështjen penale ndaj të pandehurit H.H. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 230 par.1 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25 (tutje:KPPK), duke vendosur sipas aktakuzës së ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.301/2005, të datës 26.09.2005, sipas detyrës zyrtare me datën 26.03.2024, mori këtë :

**A K T V E N D I M**

**I.- HEDHET** aktakuza e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.301/2005, e datës 26.09.2005, dhe **Pushohet** procedura penale ndaj të pandehurit :

**H.H.**, nga i ati ....., e ëma ....., i vajzërisë ....., lindur më datë ....., në fshatin ....., komuna e Skenderajit, ndërsa tani me vendbanim në Mitrovicë, Rr.“.....” nr....., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ....., për veprën penale-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 230 par.1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, **për shkak të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.**

**II.-** Në mbështetje të nenit 230 par.5 të KPPK-së dhe nenit 276 par.1 të KPP-së, **URDHËROHET** konfiskimi i përhershëm i pesëdhjetë (50) copë bimë narkotike të llojit “canabis-marihuana”. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, këto bimë narkotike duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, sipas procedurave ligjore në fuqi.

**III.-** Shpenzimet e procedurës penale, mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.

**IV.-** Palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk kishte.

## A r s y e t i m

- Ish-Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP.nr.301/2005, të datës 26.09.2005, ndaj të pandehurit H.H. nga Skenderaj, për shkak të veprës penale-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 230 par.1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së.

- Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës shkresave të lëndës, përshkrimi të gjendjes faktike, si dhe emërtimit ligjor të veprës penale si në dispozitiv të aktakuzës, në këtë lëndë penale ka gjetur se vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri H.H. përveç tij, tek kualifikimi ligjor i veprës penale si në dispozitiv të aktakuzës, evidentohet dhe B.H. në bashkëkryerje mirëpo, i njëjti nuk akuzohet me të dhënat bazë si i pandehur ashtu siç përcaktohet me dispozitën ligjore nga neni 305 par.1 të Kodit (të asaj kohe në fuqi) të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës UNMIK/RREG/2003/26 (tutje:KPPPK) apo tani neni 235 i Kodit të Procedurës Penale Nr.08/L-032 në fuqi.

Për më tepër, në fazën fillestare të hetimeve gjegjësisht në kallëzimin penal si në shkresat e lëndës Nr..... datë 31.08.2005 të Policisë së Kosovës në Mitrovicë, në cilësinë e të dyshuarit kishte qenë dhe B.H. por, që ndaj të njëjtit nuk ishte marrë deklaratë e as që ishte ndërmarrë ndonjë veprim hetimor ndaj tij. Përveç kësaj, nga Aktvendimi formal ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për fillimin e hetimeve PP.nr.301/05 të datës 31.08.2005, rezulton se hetimet kanë filluar dhe janë zhvilluar vetëm ndaj të pandehurit H.H. në drejtim të veprës penale-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 230 par.1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, ndaj të cilit më pas është ngritur aktakuza PP.nr.301/2005 me datë 26.09.2005, për të njëjtën vepër penale.

- Megjithatë, me Aktvendimin P.nr.404/2005 datë 21.11.2005 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, është konfirmuar aktakuza e Ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.301/2005 të datës 26.09.2005, sipas së cilës aktakuzë si i pandehur akuzohet vetëm H.H., për veprën penale si në këtë aktakuzë.

- Këtë lëndë penale Kryetari i Trupit Gjykses e ka pranuar me datën 19.01.2024 dhe pasi që ka shikuar në shkresat e saj ka konstatuar se, ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale për të pandehurin e lartcekur, për këtë vepër penale.

- Në nenin 90, paragrafi 1, nën-paragrafi 3 të KPPK-së, përcaktohet se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar: *“dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim”*. Ndërkaq, sipas nenit 91, par.1 të KPPK-së, *“afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale”*, paragrafi 3 përcakton: *“Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale të kryer”*, ndërsa paragrafi 4 parasheh: *“Afati i parashkrimit ndërpritet po ashtu kur kryerësi kryen një veprë tjetër penale me peshë të barabartë ose më të rëndë se sa vepra penale para skadimit të afatit të parashkrimit”*.

- Gjykata, nga shkresat dhe provat që gjenden në këtë lëndë penale si dhe nga rrethanat e këtij rasti, konstaton se nuk është paraqitur asnjë nga rrethanat që do të ndalonte rrjedhën e parashkrimit të ndjekjes penale, në afatin dhejtë (10) vjeçar, afat ky i paraparë për parashkrim relativ për këtë veprë penale.

Në rastin konkret i pandehuri është akuzuar për kryerjen e veprës penale-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 230 par.1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, për të cilën veprë penale parashihet dënimi me gjobë dhe burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

- Sipas aktakuzës, i pandehuri këtë veprë penale dyshohet ta ketë kryer me datën 28.08.2005, ndërsa veprimi i fundit i ndërmarrë në drejtim të ndjekjes penale është ndërmarrë më datë 21.11.2005, kur është nxjerr Aktvendimi P.nr.404/2005 për konfirmimin e aktakuzës, dhe nga kjo datë, e deri më tani, nuk është ndërmarr asnjë veprim në drejtim të ndjekjes penal.

- Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nga data 21.11.2005, datë kur konfirmuar aktakuza, e deri me tani kanë kaluar më shumë se dhjetë (10) vjet, dhe se brenda kësaj periudhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim me qëllim të ndjekjes penale, që do të ndërpriste rrjedhën e afatit të parashkrimit relativ, çka do të thotë se ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale në bazë të nenit 90, par. 1, nënpar 3 të KPPK-së.

- Saktësisht, parashkrimi relativ i ndjekjes penale në këtë rast penal ka arritur me datë 21.11.2015, ditë kjo kur janë mbushur dhjetë (10) vjet nga dita kur është ndërmarrë veprimi i fundit në drejtim të ndjekjes penale, ngase brenda kësaj periudhe kohore nuk është ndërprerë rrjedha e afatit të parashkrimit dhe nuk ka përfunduar ndjekja penale.

- Gjykata, bazuar në verifikimet që janë bërë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, përmes Zyrës për Menagjimin e Lëndëve njoftuar me parashtrësën me shkrim P.nr.404/2005 të datës 07.02.2024, ka vërtetuar se ndaj të pandehurit H.H. përveç kësaj lënde nuk janë zhvilluar procedura tjera penale.

Bazuar në nenin 91, par. 4 të KPPK-së, rrjedh se afati i parashkrimit ndërpritet kur kryerësi kryen një vepër tjetër penale **me peshë të barabartë ose më të rëndë se sa vepra penale para skadimit të afatit të parashkrimit**. Referuar verifikimit të bërë nga ana e gjykatës rezulton se i njëjti nuk ka kryer vepër tjetër penale që do të ndërpriste rrjedhën e parashkrimit relativ.

- Gjykata konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale ashtu që, pamundëson ligjërisht që Gjykata të ndërmerrë ndonjë veprim në drejtim të ndjekjes penale e për pasojë është rrethanë që pengon ndjekjen penale, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi që të hedh aktakuzën e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.301/2005, të datës 26.09.2005 dhe të pushojë procedurën penale ndaj të pandehurit H.H., për veprën penale-Prodhimimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 230 par.1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

- Aktvendimin mbi parashkrimin relativ Gjykata e mori në kuptim të nenit 90 par.1, nënpar.3 të KPPK-së, lidhur me nenin 357 par.1, nën par.1.3 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale (KPP).

- Gjykata vendosi si në pikën –II- të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 230 par.5 të KPPK-së, lidhur me nenin 276 par.1 të KPP-së, ashtu që ndaj të pandehurit urdhëroi konfiskimin e përhershëm të pesëdhjetë (50) copë bimëve narkotike të llojit “canabis-marihuana”, të cilat cila duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës sipas procedurave ligjore në fuqi.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

- Meqenëse palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk kishte, Gjykata nuk vendosi në kuptim të nenit 462 par.3 të KPP-së, për kërkesën pasurore juridike në këtë çështje penale.

- Nga arsyet e lartcekura e në kuptim të nenit 90, par. 1 nënpar.3 të KPPK-së e lidhur me nenin 357 par. 1, nën par.1.3 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti për Krime të Rënda**

**PKR.nr.404/2005, me datë 10.05.2024.**

**Kryetari i Trupit Gjykes,**

**Fatos Sejdijaj**

---

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej tre (3) ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.